

VENDIM
Nr. 824, datë 26.11.2014

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË
EKONOMINË PYJORE “QESHIBËS-LIQETH”, TË RRETHIT SKRAPAR, QË DO TË
PËRDORET NGA SHOQËRIA “DOBRUSHI 2010” SHPK, PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT MINERAR NË SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË RANORIT
SILICOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 6.8 (gjashtë pikë tetë) ha në ngastrat 192a dhe 193a të ekonomisë pyjore “Qeshibës-Liqeth”, objekt i aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit të ranorit silicor nga shoqëria “Dobrusha 2010” sh.p.k., të hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kulloros Publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore dhe kulloros, jepet në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore e jopyjore, sipërfaqes së hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhen nga subjekti “Dobrusha 2010” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Dobrusha 2010” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në shfrytëzim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 (tri) viteve të para, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe prej 14.14 (katërmëdhjetë pikë katërmëdhjetë) ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Dobrusha 2010” sh.p.k., nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike lidhur me detyrimet sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqja pyjore sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore/kulloros” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes sipas lejes mjedisore nga shoqëria “Dobrusha 2010” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet si fond pyjor dhe kulloros.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Dobrusha 2010” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN
 NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
 MINERAR NGA SHOQËRIA "DOBRUSHI 2010" sh.p.k. në rrethin e SKRAPARIT

QARKU BERAT

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
BR3100 0192	EP "Qeshibes-Liqeth"	192 a	Ministria Mjedisit	3.13
BR3100 0193	EP "Qeshibes-Liqeth"	193 a	Ministria Mjedisit	3.67
GJITHSEJ				6.80